



MISIONI I BASHKIMIT EVROPIAN PWR VWZHGIMIN E ZGJEDHJEVE (EU EOM)

ZGJEDHJET KOMUNALE NË KOSOVË, * 1 DHJETOR 2013

DEKLARATË PRELIMINARE

Trendi pozitiv u konfirmua në raundin e dytë

Prishtinë, 3 dhjetor 2013

PËRMBLEDHJE

- Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarë të komunave më 1 dhjetor në 25 komuna u zhvillua në një ambient të qetë në shumicën e komunave dhe garuesit patën mundësi që të bëjnë fushatë pa pengesa. Megjithatë, në disa vende janë vërejtur tensione, përfshirë edhe në disa komuna me shumicë serbe, ku kishte pretendime se ishte ushtruar presion ndaj votuesve. Për dallim nga raundi i parë, në komunat veriore me shumicë serbe nuk u vërejt fushata kundër zgjedhjeve.
- Sikurse në raundin e parë, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka vazhduar rolin e saj të lehtësimit të zgjedhjeve në komunat veriore dhe votimit jashtë Kosovës.
- Në shumicën e rasteve, rezultatet e raundit të parë nuk u kontestuan publikisht, edhe pse subjektet politike ngritën disa shqetësime, përfshirë edhe ato për numrin e madh të fletëvotimeve të pavlefshme, pasaktësi në listat e votuesve dhe kohën e gjatë që mori numërimi dhe shpallja e rezultateve.
- Pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) shpalli periudhën e fushatës zyrtare për raundin e dytë, e cila do të ishte prej 25-29 nëntor. Para kësaj, fushata disi kishte pushuar por ajo filloi të merrte hov javën e fundit para raundit të dytë.
- Shkalla, kompleksiteti dhe kohëzgjatja e aktivitetit të numërimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), dhe informatat e kufizuara që u vunë në dispozicion, nënkuptonin se transparenca e procesit ishte disi e kufizuar dhe se për vëzhguesit e kishin të vështirë ta përcillnin këtë operacion.
- Pas incidenteve në Mitrovicë të Veriut më 3 nëntor, votimi në katër komunat veriore përfundoi para kohe. Megjithatë, KQZ vendosi që t'i shpallë rezultatet për tri komuna (Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok). Votuesve të cilët do të kishin votuar pas mbylljes së parakohshme të vendvotimeve (VV) nuk ju dha mundësia për të votuar.
- Në 27 vendvotime në Mitrovicën e Veriut votimi u përsërit me 17 nëntor. Votimi kaloi pa incidente, me një prani të madhe të forcave të sigurisë. Për shkak të shqetësimeve për sigurinë, numërimi u bë në QNR afër Prishtinës, jo në vendvotime.
- Më shumë se gjysma e fletëvotimeve të dërguara nga vendet jashtë Kosovës u refuzuan sepse nuk përmbanin kopjen e dokumenteve të vlefshme të identifikimit. Megjithatë, sipas fletëpalosjes së KQZ-së në gjuhën serbe për informim të votuesve, do të ishte i pranueshëm edhe një shënim me emrin dhe të dhënat e tyre personale. Me këtë, votuesve që kishin zgjedhur këtë variant u ishte mohuar në mënyrë të padrejtë e drejta e votimit. Prandaj, zbatimi teknik i procesit të votimit jashtë Kosovës ishte i pasuksesshëm, përkundër përpjekjeve të ndryshme për lehtësimin e tij.

* Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimet ndaj statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit dhe me Mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

- Mbulimi i fushatës nga mediat fitoi në dinamikë javën e fundit, duke përfshirë edhe përmes raportimeve të zgjeruara të lajmeve, debateve të kandidatëve dhe spoteve reklamuese. Mediat u dhanë mundësi garuesve që t'i përcjellin mesazhet e tyre në mënyrë të lirshme.
- Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) pati kryesisht një qasje formaliste në procedimin e ankesave pas raundit të parë, zakonisht pa bërë hetime për dëshmitë, dhe duke hedhur poshtë shumicën e tyre.
- Votimi dhe numërimi në pjesën më të madhe të Kosovës kaloi i qetë dhe qytetarët patën mundësi të votojnë lirshëm dhe pa u penguar. MBEVZ e vlerësoi pozitivisht procesin në pothuaj të gjitha vendvotimet e vëzhguara. Në një incident të rëndë në komunën e Parteshit, disa njerëz hynë me forcë në Qendrën e Votimit dhe vodhën ose shkatërruan kutitë e votimit dhe materialet zgjedhore.

KONSTATIMET PRELIMINARE

INFORMACIONI PËRGJITHSHËM

Me 5 nëntor, Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MBEVZ) publikoi Deklaratën Preliminare me konstatimet dhe konkluzionet për raundin e parë të votimit që u zhvillua me 3 nëntor. Kjo deklaratë trajton zhvillimet nga ajo kohë e këndeje dhe duhet të lexohet si e ndërlidhur me Deklaratën e publikuar pas raundit të parë.

ZHVILLIMET POLITIKE DHE FUSHATA

Ambienti politik pas raundit të parë të zgjedhjeve me 3 nëntor në pjesën më të madhe të Kosovës ishte i qetë, me disa tensione dhe retorikë të fuqishme politike të vërejtur në disa komuna në të cilat rezultatet për raundin e dytë ishin mjaft të ngushta. Të gjithë garuesit patën mundësi t'i zhvillonin fushatat e tyre lirshëm. Në komunat veriore me shumicë serbe, ndryshe nga periudha e fushatës para raundit të parë, kësaj radhe nuk u vërejt fushata kundër zgjedhjeve. Megjithatë, në disa komuna me shumicë serbe u vërejtën tensione, përfshirë edhe pretendime për ushtrim të presionit mbi votuesit, kryesisht nga Iniciativa Qytetare G.I. Srpska. Në Shtërpçë pati incidente të vogla të dhunshme.

Më 20 nëntor, KQZ zyrtarisht certifikoi rezultatet e zgjedhjeve për kryetarë të komunave në 37 komuna (të gjitha përveç Zveçanit, ku më 1 dhjetor zgjedhjet u përsëritën në tri VV), dhe konfirmoi se balotazhi në 25 komuna do të mbahet më 1 dhjetor. Nga nëntë femra që garonin për kryetarë të komunave në raundin e parë (nga gjithsej 224 kandidatë), vetëm njëra, ajo në Gjakovë, kishte kaluar në raundin e dytë (dhe sipas rezultateve preliminare, është zgjedhur kryetarë e komunës).

Në shumicën e rasteve, rezultatet e raundit të parë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave nuk u kontestuan, ndonëse subjektet politike ngritën një varg shqetësimesh, përfshirë edhe ato për numrin e madh të fletëvotimeve të pavlefshme dhe pasaktësitë në listat e votuesve, si dhe për kohën e gjatë që mori numërimi dhe shpallja e rezultateve.

Për dallim nga raundi i parë, për raundin e dytë ligji nuk specifikon kohëzgjatjen e fushatës parazgjedhore. Në përputhje me rregulloret e KQZ-së për zgjedhjet, më 20 nëntor, KQZ shpalli se fushata parazgjedhore zyrtare për raundin e dytë do të jetë nga 25-29 nëntor. Nuk ekziston ndonjë ndalesë ligjore për subjektet politike që të bëjnë fushatë edhe para periudhës zyrtare. Sidoqoftë, para kësaj kohe, fushata ishte e kufizuar kryesisht në fushata derë më derë dhe në kontakte të drejtpërdrejta me votuesit. Gjithashtu, garuesit i shfrytëzuan mjaft shumë mediat sociale. Shumica e subjekteve politike ishin të përqendruara në negociatat për aleancat për garën e balotazhit (proces ky i ndërlikuar për faktin se ende nuk diheshin rezultatet e zgjedhjeve për asamblatë komunale, e

me këtë as fuqia relative lokale e subjekteve politike). Në përgjithësi, këto aleanca u bënë në nivelin lokal sipas preferencave të degëve të subjekteve politike. Javën e fundit para ditës së zgjedhjeve, fushata parazgjedhore disi u intensifikua dhe në disa vende përfshinte edhe tubime më të mëdha.

Sikurse para raundit të parë, MBEVZ pranoi pretendime të shumta për blerje të votave. Në Partesh, një aktivist i 'G.I. Srpska' u ndalua nga policia me pretendimin se u kishte ofruar votuesve para. Pak para raundit të dytë, tre anëtarë të 'G.I. Srpska' në Shtërpçë u morën në pyetje nga policia lidhur me pretendimet se kishin ushtruar presion ndaj votuesve.

Ndaj dy kryetarëve të komunave të zgjedhur në raundin e parë, të Skenderajt dhe Glllogovcit, janë ngritur aktakuza për krime lufte. Për më tepër, disa kandidatë që garojnë në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave janë të akuzuar ose janë nën hetime për vepra penale, përfshirë keqpërdorimin e pushtetit, korrupsionin dhe krimet e luftës. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk ua ndalon kandidimin personave që janë të përfshirë në procedura penale e të cilët nuk janë shpallur fajtorë nga gjykata.

ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Pas zgjedhjeve komunale të 3 nëntorit, organet për administrimin e zgjedhjeve u përqendruan në përllogaritjen e rezultateve dhe në përgatitjet për balotazhin e zgjedhjeve për kryetarë të komunave. Përderisa KQZ mbajti takime të rregullta, me qëllim të mbikëqyrjes së punës së QNR-së, përgatitjet administrative në nivelin komunal u intensifikuan vetëm në dy javët e fundit para zgjedhjeve. Pati ndryshime në përbërjen e Komisioneve të Vendvotimeve (KVV) në të gjitha komunat ku kishte balotazh. Anëtarët e komisioneve u zëvendësuan ose për shkak të performancës së dobët në raundin e parë ose sepse partitë që i kishin caktuar ata nuk kishin interesime për balotazh. Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) mbajtën trajnime në mbarë Kosovën, kryesisht për t'i trajtuar mangësitë procedurale që ishin vërejtur gjatë raundit të parë. Megjithatë, në disa zona këta anëtarë të rinj të komisioneve nuk ishin trajnuar në mënyrë adekuate. Misioni i OSBE-së vazhdoi të luajë rolin e tij të lehtësimit të zgjedhjeve në komunat veriore dhe të votimit jashtë Kosovës.

KQZ certifikoi rezultatet e zgjedhjeve për kryetarë të komunave me 20 nëntor. Rezultatet e votimit me kusht, atij me nevoja të veçanta dhe votimit me postë janë shtuar në rezultatet për komuna pa asnjë informacion se sa prej tyre janë refuzuar (për shkak të papranueshmërisë) ose sa ishin të vlefshme e sa të pavlefshme, ose sa prej votave të pranura ishin për secilin kandidat. Kjo bëri që të ketë mungesë të llogaridhënies lidhur me përfshirjen e këtyre fletëvotimeve. Më 2 dhjetor, KQZ shpalli rezultatet e zgjedhjeve për kuvende komunale, për të gjitha komunat përveç Zveçanit.

Numërimi i rezultateve në QNR vazhdoi ngadalë, dhe transparenca e këtij procesi ishte deri diku e kufizuar. Ndonëse vëzhguesit kishin qasje në të gjitha fazat e numërimit, shkalla, kompleksiteti dhe kohëzgjatja e këtij operacioni e bëri të vështirë përcjelljen e tij dhe informacionet në dispozicion lidhur me saktësinë e materialit zgjedhor dhe të rezultateve të numëruara ishin të kufizuara. Shumë palë të interesuara, përfshirë edhe shumë subjekte politike, shprehën pakënaqësinë e tyre me vonimin e shpalljes së rezultateve të raundit të parë dhe besim të kufizuar në punën e QNR-së dhe transparencën e saj.

Pas zgjedhjeve të 3 nëntorit, QNR mori materialet zgjedhore nga pothuaj të gjitha VV-të në tërë Kosovën. Rreth 530 kuti votimi u vendosën në karantinë gjatë pranimit për shkak të parregullsive të ndryshme. Për një javë pas zgjedhjeve, stafi i QNR-së verifikoi këto kuti dhe shumicën e tyre i cilësoi si të rregullta pasi që parregullsitë nuk ishin aq të mëdha dhe nuk kishte shenja se ka pasur ndërhyrje në të dhënat e regjistruara. Megjithatë, KQZ urdhëroi që në 61 VV të bëhet rinumërimi dhe rezultatet e tri VV-ve në Prizren u përjashtuan për shkak se mungonin listat e votuesve (përveç VV-ve të anuluar në veri – shih më poshtë). Më 12 nëntor disa pjesëtarë të stafit të QNR-së u

morën në pyetje nga policia për shkak të pretendimeve se kishin bërë përpjekje për mashtrim në zgjedhje në favor të një kandidati për kryetar komune.

Pas përfundimit të parakohshëm të votimit në VV-të në katër komunat veriore më 3 nëntor, si pasojë e incidenteve që ndodhën në tri qendra të votimit në Mitrovicën e Veriut, shumica e materialeve zgjedhore dhe kutive të votimit u sollën nga atje për t'u numëruar në QNR. KQZ vendosi t'i pranojë dhe numërojë fletëvotimet nga Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku, dhe për këto komuna i shpalli rezultatet përkundër faktit se fletëvotimet në pesë prej këtyre vendvotimeve (tri në Leposaviq dhe dy në Zveçan) u përjashtuan për shkak të mungesës së listave të votuesve. Në Mitrovicën e Veriut, KQZ vendosi t'i pranojë rezultatet nga gjashtë VV dhe që në 27 VV-të e tjera (që gjenden në tri qendra të votimit ku kishte pasur incidente) të përsëritet votimi më 17 nëntor. Më vonë, pas marrjes së vendimit nga PZAP, KQZ vendosi t'i përsëris zgjedhjet në tri VV në Zveçan. Votimi në tri VV-të në Leposaviq nuk është përsëritur. Në ato VV në veri ku nuk u përsërit votimi, përkundër faktit se ato ishin mbyllur para kohe pas incidenteve në Mitrovicën e Veriut, votuesve që do të vinin më vonë u është mohuar e drejta e votimit.

Vetëm rreth 14 për qind të personave që fillimisht kishin shprehur interesimin e tyre për t'u regjistruar për të votuar përmes postës nga vendet jashtë Kosovës kanë arritur të votojnë në zgjedhjet e 3 nëntorit. Para raundit të parë, KQZ ka pranuar rreth 11,700 zarfe me fletëvotime, shumica dërmuese e të cilave nga Serbia. Pas procesit fillestar të verifikimit, KQZ pranoi vetëm 5,600 prej tyre dhe refuzoi mbi 6,000 sosh sepse nuk kishin kopje të një dokumenti të vlefshëm identifikues të votuesit. Megjithatë, fletëpalosja e KQZ-së për informim të votuesve në gjuhën serbe i kishte çorientuar ata sepse i udhëzonte të bashkëngjisin një kopje të një dokumenti të vlefshëm identifikues ose një shënim me emrin dhe të dhënat e tjera personale të tyre. Prandaj, ata që kishin zgjedhur variantin e dytë ishin përjashtuar padrejtësisht nga KQZ nga e drejta për të votuar. Prandaj, zbatimi teknik i procesit të votimit jashtë Kosovës ishte i pasuksesshëm, përkundër përpjekjeve të ndryshme për lehtësimin e tij.

Një shqetësim i përgjithshëm pas raundit të parë ishte numri shumë i madh i votave të pavlefshme – 11 për qind e të gjitha fletëvotimeve në zgjedhjet për asamblatë komunale, sipas rezultateve preliminare. Përderisa shumica e votave të pavlefshme mund t'i atribuohen faktit se votuesit nuk e kishin kuptuar sa duhet mënyrën se si duhej plotësuar fletëvotimet, shumë vota po ashtu mund të jenë shpallur të pavlefshme nga KVV-të të cilat janë trajnuar në mënyrë joadekuate, gjë që ka shkaktuar përjashtimin e shumë votuesve nga e drejta për të votuar. KQZ është duke bërë plane që t'i analizojë këto vota të pavlefshme, t'i identifikojë arsyet dhe trajtojë këtë problem para zgjedhjeve të vitit të ardhshëm.

RIVOTIMI NË MITROVICË TË VERIUT

Para rivotimit të 17 nëntorit në Mitrovicën e Veriut, disa zyrtarë të Beogradit u bënë thirrje njerëzve që të votojnë për G.I. 'Srpska', duke theksuar se vetëm përmes votimit mund të sigurojnë zgjedhjen e kandidatit serb për kryetar të komunës. Në shumë raste, punonjësve të institucioneve publike dhe familjarëve të tyre u kërkohej të dilyn të votonin, siç raportohej, në mënyrë të organizuar. Një detyrim i tillë nuk është në pajtim me parimet për zgjedhje demokratike dhe është në kundërshtim me nenin 25 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1966).

Votimi më 17 nëntor kaloi pa incidente. Kishte një prani të madhe të organeve të sigurisë, përfshirë Policinë e Kosovës, EULEX-in dhe KFOR-in. Njerëzit patën mundësi të votojnë pa u penguar. MBEVZ dërgoi atje një ekip të vëzhguesve afatgjatë (LTO), i cili vëzhgoi 13 nga 27 VV-të ku u zhvillua votimi. Ata e vlerësuan mbarëvajtjen e zgjedhjeve si pozitive në të gjitha VV-të, ndonëse në disa vendvotime ishin vërejtur gabime procedurale. Me rekomandimin e Misionit të OSBE-së, të bërë për arsye të sigurisë, pas mbylljes së vendvotimeve KQZ shpalli se materialet e votimit do të

barten në QNR për numërim, ndonëse Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme thekson se numërimi duhet të bëhet në vendvotime. Numërimi u bë nga stafi i komisioneve të vendvotimeve (KVV) dhe nga stafi i OSBE-së. MBEVZ vlerësoi se kjo u realizua në mënyrë shumë të organizuar dhe procedurat u respektuan me përpikëri.

Rezultatet e rivotimit në Mitrovicën e Veriut treguan se do të ketë balotazh në mes të dy kandidatëve kryesorë për kryetar të komunës më 1 dhjetor. Kandidati i 'G.I. Srpska' kontestoi rezultatet duke theksuar se mund të ketë pasur ndërhyrje në fletëvotime pas mbylljes së vendvotimeve. Ky pretendim u hodh poshtë kategorikisht nga OSBE.

MEDIAT

Në përgjithësi, mediat ua mundësuan kandidatëve që t'i përcjellin porositë e tyre tek elektorati, dhe raportimi i tyre u përqendrua në periudhën zyrtare të fushatës nga 25 nëntori.

Mbulimi i zgjedhjeve nga mediat gjatë tri javëve të para pas raundit të parë të zgjedhjeve pati një rënie të konsiderueshme krahasuar me periudhën para raundit të parë. Kjo qasje në radhë të parë ishte për shkak të aktiviteteve të kufizuara të garuesve. Sidoqoftë, disa transmetues, si *Klan Kosova* dhe *KTV*, transmetuan disa debate gjatë javëve para fushatës zyrtare. Televizioni publik *RTK1* transmetoi një debat në mes të kandidatëve për Prishtinë, përfshirë edhe udhëheqësin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, i cili më herët nuk kishte marrë pjesë në asnjë debat. Pak para fushatës zyrtare, *TV21* filloi një seri debatesh, përfshirë edhe ato me ekspertë dhe me këshilltarët potencialë të asambleve komunale të zgjedhur me 3 nëntor.

Para fillimit të fushatës zyrtare, mbulimi i lajmeve në mediat transmetuese dominohej nga raportimet e zgjeruara për aktivitetet e organeve publike. Televizioni privat *TV21* ia kushtoi pjesën më të madhe të lajmeve Qeverisë, përgjithësisht me një ton neutral. Televizioni publik *RTK1* dhe ai privat *KTV* po ashtu mbuluan mjaft shumë aktivitetet e Qeverisë. Përderisa shumica e mbulimit nga *KTV* ishte neutrale, mbulimi nga *RTK1* ishte në përgjithësi neutral dhe pozitiv. Transmetuesi privat *Klan Kosova* edhe para fillimit të fushatës zyrtare kishte në fokus dy subjektet që garonin në numrin më të madh të balotazheve, LDK dhe Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), duke u kushtuar nivele të krahasueshme të mbulimit secilës nga to, si për nga koha ashtu edhe për nga toni.

Fushata u bë më e dukshme pas fillimit zyrtar të saj. Ngjashëm me fushatën për raundin e parë, mbulimi i mediave pasqyronte aktivitetin e subjekteve politike, ku LDK ishte subjekti më i mbuluar në shumicën e mediave të monitoruara në gjuhën shqipe. Gjatë fushatës zyrtare, një vëmendje e konsiderueshme nga mediat iu kushtua video-incizimit që pretendohet se paraqiste anëtarët e LDK-së duke bërë presion mbi një aktivist të Vetëvendosjes për t'iu bashkuar LDK-së. LDK hodhi poshtë këto pretendime. Raportimi i mediave për këtë video xhirim rezultoi në rritjen e vëmendjes për LDK-në në ditët e fundit të fushatës, kryesisht nga *KTV*, e cila në lidhje me këtë video xhirim raportoi në mënyrë kritike. Televizioni publik *RTK1* në përgjithësi i paraqiti të gjitha palët në mënyrë pozitive dhe neutrale, dhe mbulimi i LDK-së nga ky medium po ashtu u ndikua nga kjo video. *Klan Kosova* pati një qasje të barabartë ndaj të gjithë garuesve. G.I. 'Srpska' dominoi për nga mbulueshmëria në lajmet politike në të gjitha kanalet televizive të monitoruara në gjuhën serbe, me përqindjen më të madhe në *TV Most*. Ky mbulim nga mediat u ndikua nga kohëzgjatja e konsiderueshme e transmetimeve që ju kushtuan përfaqësuesve zyrtarë politikë nga Serbia që përkrahnin listën e 'G.I. Srpska'. Mediat i kushtuan më shumë vëmendje disa komunave të caktuara, veçanërisht Prishtinës dhe Gjakovës. Nga mediat e monitoruara, *RTK1* e mbuloi fushatën në numrin më të madh të komunave.

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) dështoi në ushtrimin e përgjegjësisë së tij ligjore të mbikëqyrjes së punës së mediave dhe të shqyrtimit dhe vendosjes për ankesat lidhur me mediat. MBEVZ mësoi se ishin paraqitur mbi 10 ankesa për aspekte të ndryshme të mbulimit nga mediat për të dy raundet e zgjedhjeve. MVZ-së nuk iu dhanë kopje të ankesave me sqarimin se procedurat ishin duke vazhduar. Megjithatë, para zgjedhjeve të 1 dhjetorit, KPM nuk mbajti asnjë takim zyrtar për të diskutuar për çështjet që kishin të bënin me zgjedhjet.

KONTESTET ZGJEDHORE

Pas raundit të parë të zgjedhjeve, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) pranoi 173 ankesa lidhur me ditën e zgjedhjeve dhe 322 lidhur me numërimin dhe rezultatet, përfshirë edhe 69 që u pranuan pas shpalljes së rezultateve për zgjedhjet për kryetarë të komunave. Gjashtë ankesa kishin të bënin me fushatën për raundin e dytë. Sikurse edhe në raundin e parë, shumica e tyre kishin të bënin me shpërndarjen e materialeve zgjedhore dhe vendosjen e afisheve. Afatet për paraqitjen e ankesave dhe zgjidhjen e tyre nga PZAP janë të shkurtra. Ankesat lidhur me procesin e votimit duhet të dorëzohen brenda 24 orëve prej mbylljes së VV-së. Ankesat lidhur me numërimin dhe rezultatet duhet të dorëzohen brenda 24 orëve nga shkelja e pretenduar. Në secilin rast, PZAP duhet të marrë vendim brenda 72 orësh nga pranimi i ankesës. Si rezultat i kësaj, ishte e vështirë për parashtruesit e ankesave që t'i përgatisin ankesat e tyre dhe për PZAP-në që t'i analizonte plotësisht ato ankesa brenda afateve kaq të shkurtra kohore. Prandaj, e drejta për mjete juridike efektive nuk është respektuar gjithmonë.

Parashtrues i ankesës mund të jetë çdo person, fizik apo juridik, i cili ka interes ligjor në një çështje, ose të drejtat e të cilit lidhur me procesin zgjedhor mendohet se janë shkelur. Megjithatë, përgjithësisht janë subjektet e mëdha politike që e kanë shfrytëzuar më së shumti mundësinë për të parashtruar ankesa. Në përgjithësi, PZAP ka vepruar në mënyrë të organizuar dhe ka respektuar afatet kohore. Siç lejohet me ligj, Paneli i ka bërë bashkë ankesat e ngjashme nga e njëjta komunë, dhe i ka trajtuar ato si një. Të gjitha vendimet e PZAP-së që u vëzhguan nga MBEVZ u morën me konsensus pas diskutimeve në mes të anëtarëve të panelit. Megjithatë, në trajtimin e ankesave, PZAP kryesisht aplikoi një qasje formaliste, shpeshherë pa i hetuar dëshmitë. Nga 173 ankesa nga dita e zgjedhjeve, vetëm 11 u miratuan. Madje, asnjë prej këtyre nuk kishte të bënte me votimin, por me shkeljet e ndalesës për të bërë fushatë në ditën e votimit. Nga ato që kishin të bënin me numërimin dhe rezultatet, u miratuan vetëm dy. Në këto dy raste, PZAP e urdhëroi KQZ-në që ose t'i përsërisë zgjedhjet ose t'i rinumërojë votat, duke urdhëruar rivotim në tri vendvotime në Zveçan (shih pjesën për Administrimin e Zgjedhjeve) dhe rinumërim në 12 vendvotime në Klinë. Për 24 prej ankesave të refuzuara, palët parashtruan ankesë në Gjykatën Supreme. Në 23 prej këtyre rasteve Gjykata Supreme mbështeti vendimin e PZAP-së dhe në një rast ajo i kërkoi PZAP-së që ta rishikojë vendimin.

Në marrjen e vendimeve për ankesat, PZAP nuk ka nisur hetime dhe nuk ka mbajtur ndonjë seancë dëgjimore. Ndonëse ligji nuk e obligon Panelin që ta bëjë këtë në secilin rast, nëse dyshohet se ankesa mund të përfshijë veprime mashtruese që kanë të bëjnë me materialet zgjedhore, PZAP mund ta caktojë një anëtar të sekretariatit që të zhvillojë hetime. Paneli pastaj duhet të marrë parasysh konstatimet e këtij zyrtari dhe të marrë vendim në bazë të këtyre informatave. Por, Paneli nuk e shfrytëzoi këtë mundësi. Në vend të kësaj, ai zgjodhi që t'i dërgojë KQZ-së kërkesa me shkrim për konfirmimin e saktësisë së pretendimeve të bëra nga parashtruesit e ankesave. Gjersa procesi i numërimit ishte në vazhdim e sipër, KQZ mund të përgjigjej vetëm se pretendimet nuk mund të konfirmoheshin në këtë fazë. Pastaj, PZAP vendosi për ankesat brenda afatit ligjor, por, në mungesë të dëshmive të nevojshme, shumicën e tyre i hodhi poshtë. Vetëm pasi ishin shpallur rezultatet, si në rastet në Zveçan dhe Klinë, qasja e PZAP-së për dërgimin e kërkesave në KQZ ka mundur të jetë e dobishme për marrjen e vendimeve të informuara për ankesat.

Shkeljet që kanë për qëllim të ndikojnë në rezultatet e zgjedhjeve, përveç se janë shkelje administrative, mund të përbëjnë edhe vepra penale. Në raste të tilla, PZAP duhet t'i përcjell këto çështje tek Zyra e Kryeprokurorit, për t'i ndjekur si vepra penale. Por kjo nuk duhet t'ia heq PZAP-së juridiksionin për përcaktimin e përgjegjësisë administrative. Megjithatë, asnjë ankesë nuk u dërgua për hetim tek Kryeprokurori.

Task Forca e përbërë nga Kryeprokurori, policia, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, PZAP dhe KQZ për t'i ndjekur veprat penale që kanë të bëjnë me zgjedhjet ka hapur 32 raste që përfshinin 58 persona për shkelje të pretenduara të të drejtave zgjedhore lidhur me zgjedhjet e 3 nëntorit.

VOTIMI DHE NUMËRIMI

Sikurse në raundin e parë, në pjesën më të madhe të Kosovës votimi kaloi i qetë dhe qytetarët patën mundësi të votonin lirshëm dhe pa pengesa. MBEVZ vëzhgoi hapjen, votimin, mbylljen dhe numërimin në 330 vendvotime në tërë Kosovën, si edhe pranimin e materialeve zgjedhore në KKZ. Hapja dhe votimi u vlerësuan si të mira ose shumë të mira në gati të gjitha vendvotimet e vëzhguara. Votimi në dy komunat veriore me shumicë serbe ku u mbajtën zgjedhjet kaloi i qetë, me prani të madhe të forcave të sigurisë.

Vëzhguesit vlerësuan se integriteti i votës është mbrojtur mjaftueshëm në shumicën e vendvotimeve. Megjithatë, në disa vende ka pasur raportime për fotografimin e votës. Si edhe me 3 nëntor, fshehtësia e votës nuk u ruajt gjithmonë. Në disa vendvotime janë vërejtur më shumë se një person në kabinën e votimit, nganjëherë për shkak të votimit familjar. Mundësia për të kërkuar ndihmë në votim është shfrytëzuar shpeshherë dhe vëzhguesit kishin konstatuar dyshime të mëdha se kjo mundësi nganjëherë abuzohej. Në një numër rastesh janë vërejtur votues që tregonin fletëvotimet e tyre jashtë kabinës, veçanërisht në Graçanicë dhe Prishtinë. Procedurat e votimit kryesisht janë respektuar, por shpeshherë nuk kontrolloheshin si duhet vulat në fletëvotime nga anëtarë i KVV-së para se vota të hidhej në kuti. Në vendvotimet e vëzhguara, kishte mbizotërim të konsiderueshëm të anëtarëve meshkuj të KVV-ve, dhe në një të katërtën e tyre, të gjithë anëtarët e KVV-ve ishin meshkuj. Në një numër të madh të vendvotimeve ishte e pamundur qasja për personat me aftësi të kufizuara të cilët nuk kishin kërkuar votim në shtëpi.

Në përgjithësi, numërimi u zhvillua shpejtë dhe pa parregullsi të mëdha, si dhe kryesisht janë respektuar procedurat. Dorëzimi i materialit zgjedhor në KKZ u vlerësua nga vëzhguesit të jetë bërë në mënyrë efikase dhe transparente, ndonëse në shumë raste, për dallim nga votimi dhe numërimi, nuk ishin të pranishëm as vëzhguesit e subjekteve politike as ata të shoqërisë civile. Në një incident të rëndë, në komunën e Parteshit, afër fundit të procesit të numërimit, disa njerëz hynë me forcë në qendrën e votimit (me tri vendvotime) dhe vodhën ose shkatërruan kutitë e votimit dhe materialin zgjedhor. Ndryshe nga raundi i parë i 3 nëntorit dhe rivotimit më 17 nëntor, numërimi në Mitrovicën e Veriut dhe në Zveçan (ku rivotimi u mbajt në tri vendvotime) u bë në vendvotime, në pajtim me ligjin.

PZAP ka pranuar një numër ankesash në ditën e zgjedhjeve të cilat, mes tjerash, kishin të bënin me pretendime për manipulim të materialit zgjedhor, blerje të votave dhe ndihmë në votim. Task Forca e udhëhequr nga Kryeprokurori kishte të shpërndarë gjithsej 60 prokurorë, 10 më shumë se në raundin e parë, të cilët punuan bashkë me policinë për ta zbatuar legjislacionin penal në ditën e zgjedhjeve. Sikurse në raundin e parë, përfaqësuesit e Task Forcës luajtën një rol të rëndësishëm dekurajues, ishin shumë të pranishëm në media dhe rregullisht ofronin informacione të reja lidhur me shkeljet gjatë zgjedhjeve. Ata njoftuan për hapjen e rasteve penale duke përfshirë edhe për votim në emër të dikujt tjetër, posedim të paligjshëm të armëve të zjarrit, pengim të votimit, keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe shkelje të vullnetit të lirë të votuesve.

Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Kosovë (MBEZV) filloi punën me 4 tetor 2013. Misioni udhëhiqet nga Shefi i Misionit Roberto Gualtieri, Deputet në Parlamentin Evropian. MBEZV ka shpërndarë në tërë Kosovën gjithsej 71 vëzhgues nga 26 vende anëtare të BE-së dhe Norvegjia dhe Zvicra për të vlerësuar tërë procesin zgjedhor në pajtim me zotimet ndërkombëtare për zgjedhje, si dhe me ligjet e Kosovës. MBEZV vepron në pajtim me Deklaratën e Parimeve për Vëzhguesit Ndërkombëtarë të Zgjedhjeve, të nënshkruar në selinë e Kombeve të Bashkuara në tetor të vitit 2005. MBEZV dëshiron t'i shpreh mirënjohjen e vet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe autoriteteve të tjera, partive politike, shoqërisë civile dhe organizatave të mediave për bashkëpunimin dhe ndihmën gjatë vëzhgimit. MBEZV i është mirënjohëse edhe Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë dhe misioneve diplomatike të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian për mbështetjen e tyre.

Kjo deklaratë publikohet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve pjesërisht do të varet nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, përfshirë edhe llogaritjen e rezultateve dhe zgjidhjen e parashtrësve dhe ankesave të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. MBEZV do të qëndrojë në Kosovë deri në fund të procesit dhe do të publikojë raportin përfundimtar me rekomandime të hollësishme brenda dy muajve nga përfundimi i procesit zgjedhor.

Raporti është në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe por vetëm versioni në gjuhën angleze është zyrtar. Një version elektronik i kësaj Deklarate Preliminare mund të merret në faqen e internetit të Misionit www.eueom.eu/kosovo2013. Për më shumë informata dhe kërkesa për intervista, ju lutem kontaktoni me Florence Marchal, Zyrtare për Media dhe Komunikim me Publikun, Mobil: +386 49 73 77 08 – florence.marchal@eueomkosovo2013.eu

Bashkimi Evropian – Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve
Hoteli Emerald, Kati II, Autostrada Prishtinë – Shkup, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel. +381 38777200; Faks. + 381 38777201
